

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magistratëve/ Seanca dëgjimore me institucionet e drejtësisë në komisionin e Ligjeve, KLP e G JL kundër formulës së PS: Rritje minimale
ADRESA	https://dosja.al/draft/pagat-e-magjistrateve-seanca-degjimore-me-institucionet-e-drejtesise-ne-ko-i514259
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:19:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	baf88bf00b04b7f128a7fc49817d9e7ff4a00232ddae0bd4604b3de347144441
TEKSTI	f44bda87e7f040178673cf909c4b012e791c83a03013b9862838e71ae3416882
PAMJA	dc1b2a791361dc2f92d58d7a2ef991d8a9451a13b55819cd758e5064c5ee1a9b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	968a685cced61fd42a0906924efae34a6f8676181be4642f1d1f5d5f436ac0d4
E MËPARSHMJA	0f01686afca0b27e0d1da34a05fbd57a217e43246663156d8cf17c2b8760fb8e
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/968a685cced61fd42a0906924efae34a6f8676181be4642f1d1f5d5f436ac0d4

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

34 MINUTA ME PARE

Pagat e magistratëve/ Seanca dëgjimore me institucionet e drejtësisë në komisionin e Ligjeve, KLP e GJL kundër formulës së PS: Rritje minimale

4 ORE ME PARE

Rekursi i Vellajt në Gjykatën e Lartë/ GJL lë fuqi vendimin e GJKKO-së, Erion Vellaj mbetet në burg

19 ORE ME PARE

107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

20 ORE ME PARE

Më 16 shtator jepet vendimi për Thačin dhe ish-krerët e UÇK-së/ Kurti: Uroj të kthehen të lirë. Ambasada e SHBA në Prishtinë: Priten protesta, kini kujdes

LIVE UPDATES

Pagat e magistratëve/ Seanca dëgjimore me institucionet e drejtësisë në komisionin e Ligjeve, KLP e GJL kundër formulës së PS: Rritje minimale

• Në Komisionin e Ligjeve po vijon shqyrtimi i nismës së socialistëve për ndryshimin e formulës së pagës referuese të magistratëve. • Në kuadër të diskutimeve janë zhvilluar edhe seanca dëgjimore me drejtues të institucioneve të sistemit të drejtësisë. • Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Gjykata e Lartë dhe institucione të tjera kanë kundërshtuar propozimin e mazhorancës, duke argumentuar se formula e paraqitur nuk respekton plotësisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese. • Gjatë fjalës së saj, kryetarja e KLP-së, Mirela Bogdani, tha se rritja e propozuar është minimale dhe se ka një diferencë të konsiderueshme me përllogaritjet e bëra nga Këshilli. • Kundër propozimit të PS-së, doli edhe zv.kryetari i Gjykatës së Lartë, Ilir Panda, i cili tha se vendimi i Gjykatës Kushtetuese përbën detyrim dhe jo thjesht orientim për ligjvënësin. • Ndërkohë, Ministri i Drejtësisë, Toni Gogu, pranoi se Kuvendi ka humbur afatin e 31 korrikut për adresimin e çështjes, por argumentoi se projektligji synon të korrigjojë situatën e krijuar. • Sipas tij, kompetenca për përcaktimin e pagave i takon Kuvendit dhe duhet të ushtrohet përmes ligjit. • Drafti i PS parashikon një rritje me rreth 8500 lekë për rrogën referuese të magistratëve. • Shifra është dukshëm më e ulët se kërkesa e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), të cilët kanë kërkuar një rritje prej rreth 80 mijë lekësh.

4 artikuj për këtë temë.

46 MINUTA ME PARE

Pagat e magistratëve/ Zv.kryetari i GJL kundër formulës së PS: Nuk e realizon standardin e vendosur nga Kushtetuesja



Ilir Panda

TIRANË- Zv.kryetari i Gjykatës së Lartë, Ilir Panda, ka kundërshtuar në Komisionin e Ligjeve formulën e propozuar për pagat e magistratëve, duke deklaruar se kalimi i pagës referuese në 38% të pagës së Presidentit nuk përbush plotësisht standardin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese. Panda theksoi se vendimi i Kushtetueses është detyrues në Kuvendin. ndai

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 13:44

Skema se si IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

ligjvënësi duhet të zgjedhë një mekanizëm që garanton realisht ruajtjen e nivelit të pagës së magistratëve në kohë.

Gjykata e Lartë kërkon rishikimin e formulës 0.38, përcaktimin e qartë të pagesave të prapambetura dhe shmangien e efekteve automatike të skemës mbi funksionarët të tjerë publikë. Sipas Ilir Pandës, Kuvendi ka hapësirë të zgjedhë formulën, por jo të shmangë standardin kushtetues. Në fund, ai theksoi se qëllimi është miratimi i një ligji që zbaton vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

"Gjykata e Lartë e vlerëson të nevojshme ndërhyrjen ligjore pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Çështja nuk është nëse Kuvendi duhet të ndërhyjë, por nëse zgjidhja e propozuar realizon standardet detyruese që lindin nga vendimi i Kushtetueses, i cili nuk përbën orientim, por detyrim për ligjvënësin. Kushtetuesja ka konstatuar papajtueshmërinë e skemës ekzistuese dhe ka përcaktuar edhe një afat për ndërhyrjen e Kuvendit. Projektligji duhet vlerësuar jo vetëm si një zgjedhje e re, por si zbatim i një vendimi përfundimtar dhe detyrues të Gjykatës Kushtetuese. Problemi kryesor është paga referuese prej 0.38 të pagës së Presidentit. Gjykata e Lartë nuk e kundërshton në parim mundësinë që ligjvënësi të zgjedhë një referencë të re, por problemi qëndron te rezultati konkret i formulës së propozuar.

Sipas Gjykatës së Lartë, kjo nuk e realizon standardin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese, për arsye se Kushtetuesja ka kërkuar një referencë dinamike, të lidhur me një pagë që rritet herë pas here dhe që ruan nivelin e mbrojtjes financiare të magistratit. Për këtë arsye, Gjykata e Lartë propozon që ligji të mos fiksojë koeficientin 0.38, por të caktojë një mekanizëm që garanton standardin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ruajtjen reale të nivelit të pagës. Gjykata e Lartë kërkon që formula prej 0.38 të rishikohet, në mënyrë që paga referuese të përmbushë standardin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese; të bëhet një ndarje e qartë e rregullimit për të ardhmen nga pagesat e prapambetura, për të cilat pasoja juridike është prodhuar pas datës 31 korrik; si dhe të shmangen efektet automatike mbi funksionarët e tjerë publikë. Kuvendi ka hapësirë për të zgjedhur formulën, por jo për të mos zbatuar standardin kushtetues. Ligji i ri duhet ta zgjidhë çështjen për të ardhmen, por pa fshirë pasojën e vendimit të Kushtetueses. Qëllimi nuk është miratimi i një ligji, por miratimi i një ligji që zbaton vendimin e Gjykatës Kushtetuese", tha zv.kryetari i Gjykatës së Lartë, Ilir Panda./Dosja.al

53 MINUTA ME PARE

Pagat e magistratëve/ Kryetarja e KLP-së kundër draftit të PS: Rritje minimale, nuk reflekton standardin e Kushtetueses



TIRANË- Në komisionet parlamentare po vijon shqyrtimi i nismës së PS-së për ndryshimin e formulës së pagës referuese të magistratëve. Në kuadër të diskutimeve janë zhvilluar edhe seanca dëgjimore me drejtues të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Gjatë fjalës së saj, kryetarja e KLP-së, Mirela Bogdani, ka kundërshtuar formulën e propozuar nga PS, duke e cilësuar rritjen minimale dhe shumë larg përlllogaritjes së bërë nga vetë Këshilli.

Ajo theksoi më tej se këshilli ka vlerësuar se, në një ndërhyrje në sistemin e pagave të magistratëve, duhet të shihet oportuniteti për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm, jo thjesht një ndërhyrje për të përmbushur formalisht detyrimin e vendosur nga GJK.

"Këshilli ka vlerësuar se, në një ndërhyrje në sistemin e pagave të magistratëve, duhet të shihet oportuniteti për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm, jo thjesht një ndërhyrje për të përmbushur formalisht detyrimin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese. Në vijim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi ka kaluar edhe afati i 31 korrikut, Këshilli ka diskutuar në seanca se ku duhet të jetë paga referuese. Pavarësisht kësaj, ne ndonëse nuk jemi njohur në detaje me projektligjin që është kaluar dje nga Komisioni i Ekonomisë, në referim të atij informacioni që kemi marrë për një rritje 0.02%, pra një rritje që është minimale krahasuar me atë që ka përlllogaritur vetë Këshilli, do të thoja se ka një diferencë shumë të madhe. Nuk reflekton standardin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese dhe standardin që vetë referimi i pagave ka bërë për sistemin e administratës shtetërore", u shpreh Mirela Bogdani.

Drafti i PS parashikon një rritje me rreth 8500 lekë për rrogën referuese të magistratëve. Shifra është dukshëm më e ulët se kërkesa e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLJG) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), të cilët kanë kërkuar një rritje prej rreth 80 mijë lekësh./Dosja.al

POLITIKE 15 SHTATOR 2026, 13:00

"Paga bruto e një magjistari"/
Gafat e njëpasnjëshme të
deputetes socialiste: Mos e
bëni kaq të madhe, është laps

ART&ARGËTIM 15 SHTATOR 2026, 10:17

Matthew Rhys bën histori në
Emmy Awards, bëhet aktori i
parë që fiton dy çmime
kryesore në një natë

më të klikuarat



Pse bën foto? Rama kap të
rriun nga qafa dhe ia dorëzon
policisë, çfarë ndodhi në
Aeroportin e Napolit?
(VIDEO)

Vrasja e Franc Konomit,
flasin familjarët e tij/
Gruaja: Hotelin ia mori
vëllai dhe ia shiti. I biri:
Kanë dashur të më vrasin
edhe mua dy herë

Dhunuan me grusht
qytetarin gjatë arrestimit,
Taulant Balla i del në
mbrojtje Policisë: Bën
detyrën e tyre

Audiopërgjimi zbardh
skemën si Roni Yeffet
instrukton ukrainasit:
Shkoni në Vlorë dhe thoni se
përfaqësoni një kompani
amerikane

insights

Ola Xama

Republika e 1
euroshit ku Rama
zgjedh kush bëhet
biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi
shqiptar për tu
përshtatur me
tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e
"shkarkoi" sot Edi
Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E
TRIBUNALIT


“I lidhni shallin sa herë ka mbledhje me partizanë”/ Korreshi përplasat me Gogun për Sokol Sadushin, ministri: Nuk e ke kuptuar ende punën e një deputeti(VIDEO)



Toni Gogu, Sokol Sadushi dhe Saimir Korreshi

TIRANA- Deputeti i Partisë Demokratike, Saimir Korreshi dhe Ministri i Drejtësisë, Toni Gogu janë përplasur ditën e sotme gjatë Komisionit për Çështjet Ligjore. Ndërsa Korreshi po fliste për gjyqtarët, ministri Gogu iu drejtua duke i thënë se deputeti demokrat është i vetmi njeri që nuk ka kuptuar efektet e veprimtarisë së tij përmes pyetjeve.

Gogu e konsideroi fjalimin e Korreshit si një barsoletë, ndërsa i rekomandoi të lexoj vendimin e GJK dhe të sjell një projekt i cili do ta adresonte më mirë problematikën. Pas kësaj ka ardhur edhe përgjigjia e deputeti demokrat, i cili tha se barsoleta e tij është marrë nga Sokol Sadushi, kryetari aktual i Gjykatës së Lartë.



Pjesë nga debati:

Toni Gogu: Kam përshlypjen që i vetmi njeri që nuk ka kuptuar efektet e veprimtarisë së tij përmes pyetjeve, më duket se jeni ju, sepse midis një deputeteje që ka përgatitur një projekt mirë apo keq, por e ka sjellë në zbatim të vendimit dhe një deputeti që tregon barsoleta për keqfunksionimin e gjykatave është një det i tërë. Do ju thosha: lexoni vendimin e GJK, sillni një projekt dhe mundet që projekti ta adresojë më mirë problematikën.

Saimir Korreshi: O i nderuar, i fort i nderuar kryetar. Tha barsoletë.

Ulsi Manja: Barsoleta nuk është e ndaluar në fjalor.

Saimir Korreshi: Po dale tani, duro. T'i tregoj ministrit se unë barsoletën e mora nga Sokol Sadushi. Është një barsoletë që e ka thënë kryetari i GJL drejtuar kryetarit të KLGJ, është barsoletë. Atij kryetari të komitetit të GJL që e mbani me shall sa herë ka mbledhje për partizanë, ju e quani barsoletë. E kuptoni ku jemi, po flasim për vendimet e GJK. Ne të kërkuam

ANALIZAT/ Rreth tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by tomorrow.

2 ORE ME PARE

Pagat e gjyqtarëve/ Ministri Gogu: Vonesa e Kuvendit nuk duhet të krijojë përplasje mes pushteteve



Toni Gogu

TIRANA- Ministri i Drejtësisë, Toni Gogu ka folur në lidhje me pagat e gjyqtarëve, duke thënë se vonesa e Kuvendit për ndërhyrjen ligjore mbi pagat e gjyqtarëve nuk duhet të kthehet në përplasje mes pushteteve. Duke folur në Komisionin e Ligjeve, Gogu u shpreh se ngarkesën e gushtit, që nuk është muaj seancash, e kanë mbajtur sekretaria gjyqësore, gjyqtarët e masave të sigurisë, nëpunësit gjyqësorë, nëpunësit e administratës, që nuk kanë asnjë lidhje me këtë projekt.

Më tej, ministri tha se nuk mund të zhbëhet arkitektura e Kuvendit sipas nevojës së çastit, duke shtuar se rregulli qëndron për të gjithë. Gogu tha se afati i Kuvendit kishte përfunduar më 31 korrik, por theksoi se nisma e re synon të korrigjojë këtë vonesë. Kjo duke respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe kompetencat e Kuvendit.

Toni Gogu: Kuvendi e humbi afatin, këtë një pjesë e juaja sapo e konstatoi, ishte me 31 korrik. Nuk ka nevojë të justifikohemi asnjëri. Jemi të hapur të mbajmë përgjegjësinë që duhet të kemi në këtë proces. Jam këtu për të mbështetur një nismë tuajën dhe mendoj se duhet vepruar me shpejtësi.

Ngarkesën e gushtit, që nuk është muaj seancash, e kanë mbajtur sekretaria gjyqësore, gjyqtarët e masave të sigurisë, nëpunësit gjyqësorë, nëpunësit e administratës, që nuk kanë asnjë lidhje me këtë projekt dhe janë jashtë kësaj mosmarrëveshjeje. Në lidhje me këtë dua të shpreh edhe një keqardhje për ta.

Dua të them një gjë shkoqur: Ju me të drejtë e ngritët vonesën e Kuvendit, që ishte vonesa e afatit. Por një gabim, i shtuar me një gabim të dytë nuk barazon një ndreqje. Vonesa e Kuvendit nuk duhet të krijojë gabimin e përplasjes së pushteteve. Projekti që sillni ju sot bën një ndreqje të gabimit të krijuar nga një vonesë. Pyetja e debatit nuk është sesa duhet të marrë një gjyqtar, por se kush duhet të vendosë për formulën e pagës, jo vetëm të magjistratit.

Këtë nuk e them unë, por Gjykata Kushtetuese. E vendos Kuvendi dhe e vendos me ligj. Argumenti i palës tjetër ka qenë se mosveprimi i Kuvendit do të na lërë pa pasojat e Kushtetueses dhe heshtja e Kuvendit mund të zhbëjë vendimin e Kushtetueses. Ky ka qenë një argument dhe është serioz, nuk mund të banalizohet. Vendimi që kërkon ndërhyrjen e ligjvënësit meriton vetëm ligj. Mosveprimi i Kuvendit nuk mund të zgjidhet me marrje kompetencash dhe mënyra të tjera.

Arkitekturën kushtetuese nuk mund ta zhbëjmë sipas nevojës së çastit. Rregulli qëndron për të gjithë. Formula e një page qëndron mbi Kuvendin. Një pagë rëndon buxhetin e shtetit dhe kjo formulë qëndron mbi Kuvendin. Boshllëku ligjor i krijuar nuk mbushet me një kompetencë të re të krijuar me vrap kush mbërrin atje më para. Kompetenca është e Kuvendit dhe duhet të zbatohet, siç po bëni ju sot.

Nuk kam ardhur të mbroj asnjë numër, Ministria e Financave ka ndikimin e vet në lidhje me peshën në Buxhetin e Shtetit dhe zbatimin e vendimit të Kushtetueses. Dua ta mbyll me një mesazh. Kur ky Kuvend dhe të gjithë ju që jeni të pranishëm vendosët rregullat e reformës në drejtësi në 2016, ishin tre parime kryesore: Integriteti, llogaridhënia dhe efikasiteti.

Integriteti është realizuar me kosto të madhe institucionale. Pavarësia është mbrojtur çdo ditë dhe kjo e shtesës së pagave është një shembull. Llogaridhënia ka mbetur në letër dhe duhet parë me shumë vëmendje, sepse vlen për çdo pushtet. Pavarësia pa llogaridhënie rrëshqet drejt papërgjegjshmërisë.

Kjo jo prej njerëzve, por sepse çdo pushtet nuk mund të mbështetet tek aftësia për të korrigjuar veten. Nuk është qëndrim ndaj drejtësisë, por është projektuar një mur në atë shtëpi të drejtësisë, që sot mungon. Vendimet e Kushtetueses duhet të zbatohen, por duke respektuar njëkohësisht si atë çfarë ajo ka vendosur, por edhe rendin kushtetues të

Sondazh

Poll

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.